



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 185/6 prot.

Tiranë, më 7.5.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 344, datë 11.2.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Marinela Osmani (Nuni)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 22.4.2021, është njoftuar vendimi nr. 344, datë 11.2.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Marinela Osmani (Nuni), magjistrate/gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë *(në momentin e dhënies së vendimit, me detyrë Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor)*.

Referuar këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “C”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2¹ e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 22.4.2021, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, paraqitur nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar Rekomandim).

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

¹ “2. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.”

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 22.4.2021, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 344, datë 11.2.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni) magjistrate/gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (*në momentin e dhënies së vendimit, me detyrë Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor*), në zbatim të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1² e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e Vlerësimit të Figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe Raportin e Vlerësimit Profesional nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Marinela Osmani,*”³ ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela *** Osmani⁴, ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela *** Osmani*”.

2.3 **KLGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore, të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁵ për Analizimin e Aftësisë Profesionale të subjektit të rivlerësimit Marinela Osmani.

² Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

³ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/*** prot., datë ***.5.2018.

⁴ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë ***.11.2017, e deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.10.2020.

⁵ Raport i KLGJ-së nr. ***/*** prot., datë ***.11.2020.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë [...]*⁶. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...]*⁷. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...]*⁸. Në këto kushte, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 344, datë 11.2.2021, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1, ka vendosur: [...] *1. Konfirmimin në*

⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 39 të vendimit.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor (e komanduar) [...].

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Në mënyrë të përmbledhur, Rekomandimi i datës 22.4.2021, pasi sjell në vëmendje se vendimet e Kolegjit vendosin standarde për interpretimin e dispozitave ligjore të ligjit nr. 84/2016, duke siguruar kështu udhëzime për organet e rivlerësimit në raste të ngjashme, shprehet se: [...] *Gjetjet në rastin e *** dhe Marinela Osmanit nuk janë vetëm të ngjashme, por “de facto” identike, gjë që nxjerr në pah (të paktën prima facie) mospërputhjen e standardeve të përdorura nga Komisioni në vendimin që konfirmon Marinela Osmanin, kundrejt atyre të zbatuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin 20/2019 (dhe në vendimet e mëparshme), pa dhënë një arsyetim të kënaqshëm për këtë dallim [...].*

6. Rekomandimi parashtron nevojën që, nëpërmjet ankimit të Komisionerit Publik, ndaj vendimit të Komisionit, çështjet të shqyrtohen nga ana e Kolegjit, me qëllim që ai të vlerësojë siç duhet, në përputhje me standardet ekzistuese dhe, nëse eventualisht zgjidhja e kësaj çështje do të jetë e ndryshme nga ajo e subjektit *** ***, të japë arsyetimin e duhur për një dallim të tillë, duke siguruar parime udhëzuese për raste të ngjashme për subjektet e rivlerësimit, të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjerë rivlerësimi.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

11. Në referencë të kësaj pozite procedurale në procesin e rivlerësimit, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të datës 22.4.2021, vlerëson se vendimi nr. 344, datë 11.2.2021, i Komisionit, ka nevojë t'i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, me qëllim që të vlerësohet praktika ekzistuese dhe, nëpërmjet vendimit të tij, Kolegji të mundet

eventualisht të orientojë Komisionin në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, në rastet kur subjekti i rivlerësimit konkret dhe bashkëshortja/bashkëshorti i tij (person i lidhur), janë njëkohësisht subjekte të rivlerësimit, në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

12. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), ka qenë në cilësinë e personit të lidhur/bashkëshorte e një tjetër subjekti të rivlerësimit, ish-magjistratit z. *** ***, prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Nisur nga fakti, që z. *** ***, ishte një kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në kohën kur ndaj tij u zhvilluan procedurat e procesit të rivlerësimit, ky proces u konsiderua si prioritar në kohë.

13. Me vendimin nr. 61/2018, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. *** ***. Komisioneri Publik, pas paraqitjes të një Rekomandimi nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, ushtroi ankim ndaj këtij vendimi.

14. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit të paraqitur, Kolegji, me vendimin (JR) nr. 20/2019, vendosi ndryshimin e vendimit nr. 61/2018, të Komisionit, duke shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, z. *** ***, pas konstatimit të kushteve të parashikuara nga pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

15. Nisur nga rrethanat specifike të rastit, kur të dy bashkëshortët ishin njëkohësisht subjekte rivlerësimi, në vendimin e Kolegjit nr. 20/2019, për sa i takon zhvillimit të procesit të rivlerësimit për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit në atë gjykim, subjektit të rivlerësimit në këtë çështje konkrete, për të përjashtuar ndikimin e vendimmarrjes për z. *** Osmani, në procesin e subjektit konkret të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), argumentohet se: *[...] trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është gjithashtu subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, dhe sqaron se ky vendim në asnjë mënyrë nuk paragjykon të drejtën e saj për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe një rivlerësim në përputhje me ligjin nga organet e rivlerësimit. Vendimi i dhënë në këtë rast nuk do të afektojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit, të cilin bashkëshortja e subjektit ka të drejtë ta ketë, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së saj dhe në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit [...]*⁹.

16. Me gjithë argumentin e dhënë nga Kolegji, në vendimin e tij (JR) nr. 20/2019, nuk rezulton se këtij interpretimi t'i jetë dhënë vlera e orientimit në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, në kuptim të pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016.

17. Referuar Deklaratës “Vetting” dhe Deklaratave Periodike Vjetore, konfirmuar edhe nga hetimi administrativ, subjekti i rivlerësimit, znj. Osmani, dhe personi i lidhur me të, z. *** ***, (bashkëshorti), ndër të tjera, kanë deklaruar këto pasuri:

⁹ Referohuni vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, prg. 78.

- **Pasuritë e paluajtshme**

17.1 *Apartament banimi¹⁰ me sipërfaqe 108 m², ndodhur në qytetin e Tiranës, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi llogarinë bankare në Bankën ***, e krijuar nga të ardhurat nga shitja e apartamentit 72 m², ndodhur në rrugën “**** **”, Tiranë dhe nga shuma 2.000 euro, të ardhura nga kursimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni) dhe personit të lidhur.*

- **Pasuritë e luajtshme**

17.2 *Automjet me targë AA *** ***, i markës Volkswagen, blerë në çmimin 400.000 lekë, kontratë e datës ***.7.2015, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi kursime të subjektit, znj. Osmani, dhe personit të lidhur.*

17.3 *Kursime cash, në shumën 400.000 lekë, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi kursime të subjektit, znj. Osmani, dhe personit të lidhur.*

17.4 *Llogari bankare pranë Bankës ***, në shumën 20.060 euro, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi kursime të subjektit, znj. Osmani, dhe personit të lidhur.*

18. Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton se në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit, znj. Osmani, dhe personi i lidhur me të, ndër të tjera, kanë deklaruar si vijon:

18.1 Në *Dv-2011*, kanë deklaruar: (i) kursime *cash* në shumën 500.000 lekë, me burim krijimi kursime nga të ardhurat e punës së subjektit, znj. Osmani, dhe personit të lidhur; (ii) shlyerje të huas kundrejt personit tjetër të lidhur, z. ***. ***, në shumën 7.000 euro.

18.2 Në *Dv-2013*, kanë deklaruar: (i) kursime *cash* në shumën 1.450.000 lekë, me burim krijimi kursime nga të ardhurat e punës së subjektit, znj. Osmani, dhe personit të lidhur; (ii) shlyerje të huas kundrejt personit tjetër të lidhur, z. ***. ***, në shumën 8.000 euro.

18.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), nuk ka pasur mundësi financiare, gjatë viteve 2011 - 2013, për të shlyer huan, të shtojë kursimet vit pas viti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, duke i kaluar për këto çështje edhe barrën e provës¹¹.

18.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova¹².

18.5 Sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *Në përfundim të analizës, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen cash, shlyerjen e huas, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë, duke u gjendur, për pasojë, përpara parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.*

Trupi gjykues rendit disa rrethana faktike lidhur me ndikimin që merr kjo balancë negative ndaj subjektit të rivlerësimit në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje:

¹⁰ Deklaruar në D-Vetting, me sipërfaqe 96 m² dhe 12 m² ambiente të përbashkëta.

¹¹ Referohuni dokumentit: “Rezultate të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani”, f. 16.

¹² Referohuni dokumentit: “Prapësime ndaj rezultateve të hetimit administrativ të subjektit, znj. Marinela Osmani”, f. 19 - 22.

- i. Ajo është e njëjtë me atë për të cilën edhe u aplikua masa disiplinore ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me vendimin përfundimtar të KPA-së.
- ii. Pasuria, në vlerësimin e provave dhe bindjen e brendshme, rezultoi e deklaruar me saktësi dhe e krijuar me burime të ligjshme.
- iii. Nga hetimi tërësor nuk u konstatuan të dhëna lidhur me pasuri të fshehura, deklarime të rreme apo ndonjë problematikë tjetër sa i përket këtij kriteri.
- iv. Për sa më sipër, rrethanat e mbetura nga kriteri i pasurisë janë vlerësuar në harmoni edhe me procesin e rivlerësimit për dy kriteret e tjera, për të cilat nuk rezultoi ndonjë problematikë.
- v. Aplikimi i së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, në vështrim të konstatimeve të renditura më sipër, nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 [...] ¹³.

18.6 Komisioneri Publik konstaton se, lidhur me këtë situatë faktike të referuar sa më lart për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), për efekt të procesit të rivlerësimit të z. *** ***, në referencë të vendimit nr. 20/2019 të Kolegjit, është argumentuar se: [...] “sa i përket shkakut që lidhet me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të përballuar krijimin e pasurisë likuiditet, në formën e gjendjes cash, dhe të shpenzimeve për jetesë e shlyerjen e detyrimit ndaj personit tjetër të lidhur, në vitet 2011 e 2013, mungesë e cila e çon Kolegjin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit *** *** nuk ka justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në pronësi të tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa ‘b’ e ligjit nr. 84/2016”. ¹⁴

18.6.1 Duket se Komisioni, në vendimin e tij konkret, mjaftohet me një konstatim se balanca negative në shumën 1.785.365 lekë, në raport me katër rrethana faktike (renditur si i. - iv., si më lart) dhe vlerësimi tërësor i çështjes nuk çon në aplikimin e së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, pasi nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

18.6.2 Referuar përmbajtjes së nenit 52/1 të ligjit nr. 84/2016 është prerogativë e Komisionit, ashtu sikurse dhe e Kolegjit, që vendimmarrjen, edhe në procesin e rivlerësimit të znj. Marinela Osmani (Nuni), ta mbështesë në zbatimin e parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Vetë Kolegji e ka drejtuar vëmendjen e Komisionit në zbatimin e këtyre parimeve, në vendimin (JR) nr. 20/2019.

18.6.3 Megjithatë, në vlerësim të përmbajtjes së pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, në vendimin konkret të Komisionit, për efekt të rivlerësimit të pasurisë së luajtshme të përmendur në pikat 17.2 - 17.4 të këtij ankimi, në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, vetëm citohen rrethanat e çështjes, por ato nuk shoqërohen me përfundimet/arsyetimet që ka nxjerrë/përdorur Komisioni nga vlerësimi i këtyre rrethanave, duke iu referuar zbatimit të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit.

¹³ Referohuni vendimit të Komisionit, f.23.

¹⁴ Referohuni vendimit (JR) nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, prg. 77.

18.6.4 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, çmon si të nevojshme që kjo çështje të paraqitet për shqyrtim në Kolegj dhe, nëse eventualisht zgjidhja e kësaj çështjeje do të jetë e ndryshme nga ajo e subjektit të rivlerësimit, z. *** ***, nga Kolegji të jepet arsyetimi i nevojshëm/i duhur, duke siguruar parime udhëzuese për raste të ngjashme për subjektet e rivlerësimit, të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjerë rivlerësimi.

V. Kërkimi i ankimit

19. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

20. Duke nënvizuar se Komisioneri Publik, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “C”, të aneksit të Kushtetutës, është institucioni i rivlerësimit, të cilit Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i drejton rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit;

21. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë në mënyrë alternative:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.2.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Ndryshimin e këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i ONM-së, nr. 271/1 prot., datë 22.4.2021.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Nr. 185/2 Prot.
Datë, më 22. 4. 2021 ore 16:35

International Monitoring Operation
Prot. No. 271/1
Date 22 104 2021

International Monitoring Operation

*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Funded by the European Union

Tirana,

**To the
Institution of the Public Commissioners
Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Nr. 6
Tirana
Albania**

Case Number DC/TIR/1/48

Assessee **Marinela OSMANI**

RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL

according to

Constitution of the Republic of Albania, Annex 'Transitional Qualification Assessment', Article B, paragraph 3, littera c

Introduction

The assessee Marinela Osmani, judge of Tirana District Court, holds now the position of Legal Adviser in the Support Unit of the Committees in the High Judicial Council. She is assessed *ex officio* pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution of the Republic of Albania.

The Re-evaluation process was concluded based on three criteria: assets, background and proficiency. The Independent Qualification Commission (hereafter: IQC) Adjudication Panel, finally closed the investigation on 14.01.2021, notified the assessee the additional findings, and

the assessee remained with the burden to provide evidence or arguments against the preliminary conclusions based on the assets and proficiency assessments.

Following her submissions to rebut the established presumption, the panel decided to summon the assessee to the hearing.

The hearing took place on the 9th of February 2021 and following the deliberation as per Article 55 paragraph 5) Vetting Law, the Adjudication Panel decided to confirm the assessee in duty pursuant to Article 59 Vetting Law, and the decision was announced publicly on the 11th of February 2021.

Summary of the Recommendation

The International Observers recommend to the Public Commissioners to file an appeal against the decision of the Independent Qualification Commission of the 11th of February 2021 in the case of the assessee Marinela Osmani, case number DC/TIR/1/48, by which she was confirmed in duty.

Basis of the Recommendation

1. Under paragraph 3 of Article D of the Annex to the Constitution of the Republic of Albania” *The assessee has to credibly explain the lawful origin of assets, property and income. Income shall only be considered legitimate if it has been declared and taxes have been paid.*”

Whereas, under paragraph 5 of the same article, “*if the assessee takes steps to inaccurately disclose or hide assets in his or her ownership, possession or use, a presumption for the disciplinary measure of dismissal shall be established which the assessee shall have the burden to dispel.*”

Furthermore, under article 52 paragraph 2 Vetting Law, “*if the Commission or the Appeal Chamber concludes that the evidence has reached the standard of proof under Article 45 of this Law for its report, the assessee shall have the burden to provide evidence or arguments about evidence against that conclusion.*”

2. The Adjudication Panel, upon closing the administrative investigation, found that the assessee on several occasions did not accurately disclose some assets and failed to provide sufficient evidence supporting the legitimacy of some of the sources of financing. The

Panel also requested clarification about some of the judicial proceedings conducted by her. As a consequence, the burden of proof, as per article 52 paragraph 2 Vetting Law, was shifted to the assessee in the asset and proficiency pillars.

3. The assessee, replying to the preliminary conclusions of the IQC, submitted her interpretation of the financial analysis and her explanation on some of the issues raised against her. The assessee also provided her analysis of the factual and legal conclusions of the decision of the Special Appeal Chamber Nr. 20/2019, concerning the re-evaluation of her related person and husband, Mr *** ***. She elaborated about the implications of such decision for her own re-evaluation case.
4. The panel invited the assessee to the hearing, where she exposed and further explained the same arguments previously presented in writing.
5. The adjudication panel, after evaluating all circumstances and accepting several of the assessee's explanation, concluded that the assessee had provided sufficient explanations to rebut all preliminary conclusions on proficiency and most of the preliminary conclusions on asset. The Panel however, concluded that, notwithstanding all clarification provided by the assessee, the latter was still unable to justify financial resources to cover all the registered expenses, namely lacking lawful financial sources to justify her assets, the cash balance, or to cover the expenses incurred in 2011 and 2013, amounting to ALL (-) ~~1,785,365~~. The assessee was nonetheless confirmed in duty.
6. Given the foregoing, the International Observers note as follows:
 - a. The revised financial analysis of the Independent Qualification Commission, following the assessee's replies to the conclusions of the investigation, found that the resources and savings declared by the assessee were insufficient to cover the recorded expenses in the years 2011 and 2013, with an overall exposure of ~~1,785,365~~ ALL.

- b. The International Observers note that the IQC's factual conclusions in the case of Marinela Osmani reveal a slightly higher financial exposure for this assessee, compared to the conclusions reached by the Special Appeal Chamber in its decision nr. 20/2019 against the assessee's husband, Mr **** ** (where the only shortcoming consisted in the assessee lacking 1.760.497 ALL in the years 2011 and 2013).

Based solely on such conclusions, the Special Appeal Chamber decided to dismiss the assessee's husband.

- c. The International Observers are mindful that it is the IQC's duty to assess each case individually, without the decision rendered by the Special Appeal Chamber against **** ** having any formal binding force against Marinela Osmani, even on those patrimonial/financial situations which *** and Marinela Osmani have in common (due to their being related persons).
- d. On the other hand, it must be remembered that the decisions of the Special Appeal Chamber set standards for the interpretation of legal provisions of the vetting law, thus providing guidance for the vetting bodies in similar cases. Now, as said, the criticalities in the cases of *** and Marinela Osmani are not only similar, but *de facto* identical, which highlights (at least *prima facie*) the inconsistency of the standards adopted by the IQC in the decision confirming Marinela Osmani versus those applied by the Special Appeal Chamber in decision 20/2019 (and in previous decisions), without the IQC having provided a satisfactory reasoning for such distinguishing.
- e. It appears therefore necessary that the case be brought to the attention of the Special Appeal Chamber, through appeal of the Public Commissioners. The Special Appeal Chamber should properly assess the present case in light of the existing standards and - if eventually the solution of the present case were to be opposite from that of **** ** - give adequate reasoning for such distinguishing, thus providing guiding principles for similar cases of assessees who are related persons of other assessees.

7. Because of the foregoing, the IMO recommends an appeal against the IQC Decision pronounced on 11 February 2021 in the case of assessee Marinela Osmani.

International Observer

International Observer

International Observer

